Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0989

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Isa Hasani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së OE "CTA" Sh.p.k., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Faza e dyte e punimeve ne QTM, te ndara ne tri lote LOT 1 Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujësjellësit LOT 2 Punimi i Dyerve dhe dritareve LOT 3 Punimet e lyerjes pllakave dhe fasadës" me numër të prokurimit 635-23-10151-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës, më 08/03/2024, mori këtë:

Vendim

1. Anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit "Faza e dyte e punimeve ne QTM, te ndara ne tri lote LOT 1 Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujësjellësit LOT 2 Punimi i Dyerve dhe dritareve LOT 3 Punimet e lyerjes pllakave dhe fasades", me numër të prokurimit 635-23-10151-5-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Pejës.

2. Mbetët ne fuqi vendimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, si në pikën I të dispozitivit.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 21.09.2023, Komuna e Pejës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Faza e dyte e punimeve ne QTM, te ndara ne tri

lote LOT 1 Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujësjellësit LOT 2 Punimi i Dyerve dhe dritareve LOT 3 Punimet e lyerjes pllakave dhe fasades", me numër të prokurimit 635-23-10151-5-1-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 613,712.66 € vlera Totale e 3 Loteve. LOT 1 Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujësjellësit Vlera: 344.885.76 Euro, LOT 2 Punimi i Dyerve dhe dritareve Vlera: 79.465.00 Euro, LOT 3 Punimet e lyerjes pllakave dhe fasadës Vlera: 189.361.90 Euro.

Me 28.11.2023 "CTA" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 30.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 07.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "CTA" SH.P.K me nr. 989/23 lidhur me aktivitetin "Faza e dyte e punimeve ne QTM, te ndara ne tri lote LOT 1 Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujësjellësit LOT 2 Punimi i Dyerve dhe dritareve LOT 3 Punimet e lyerjes pllakave dhe fasades", me numër të prokurimit 635-23-10151-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigja e AK-së në kërkesën për rishqyrtim të OE ankues "CTA" SH.P.K: "AK pas analizës se kërkesës se juaj për Ri-shqyrtim duke marr për bazë kërkesën tuaj në platformën elektronike të datës: 28.11.2023, është trajtuar me kujdes kërkesën tuaj, dhe ka ardhur ne përfundim se njëjta është e pa bazuar. Ju njoftojmë se pretendimet e juaj ankimore janë te pa bazuara pasi qe ne si AK kemi vepruar konform LPP-se, pasi qe ka ndodhur një gabim teknik te paramasa parallogaria pozicioni A. 6 Shkuma për fiksim me montim te Sasia nuk është vendosur fare vlera dhe është një gabim i pa riparueshëm ne ketë proces po ashtu edhe ju ne ofertën e juaj te dorëzuar me datën 01.11.2023 tek paramasa parallogaria tek ky pozicion te njësia Çmimi me TVSH këndi vendosur çmimin ndërsa te vlera totale nuk keni vendosur fare çmim qe është ne kundërshtim me LPP-ne. Andaj, ne si AK ju njoftojmë se pretendimet e juaja ankimore janë te pa bazuara, dhe ne kemi vepruar konform LPP-se dhe Rregullave. Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato qe u thane me lartë ka vendosur si ne dispozitiv".

Pretendimet e Operatorit Ekonomik Ankues OE "CTA" SH.P.Kjanë parashtruar si në vijim:

Ankuesi pretendon se: "Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit përkatësisht kundër anulimit "LOT 1 Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujësjellësit" pas publikimit të B58 Njoftimit mbi vendimin e autoriteti kontraktues. Operatori ekonomik ankues "CTA" Sh.p.k pretendon se AK në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, dhe nenin 43 të paragrafi 5 të Rregullores nr.001/2022, ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me këto dispozita, po ashtu ankuesi potencon se ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me ekzekutimin e punimeve, LPP ja mundëson AK që nëse nuk ka paraparë sasinë, duhet ti shtoj sasitë përmes Aneks kontratës deri në 10% të vlerës totale të kontratës. Te paramasa parallogaria

pozicioni A .6 Shkuma për fiksim me montim kushton katër (4) euro, AK e ka shumë të letë qe këtë gabim teknik te tyre ta përmirësoj duke u bazuar ne dispozitat ligjore. Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës kundrejt pretendimeve ankimore, operatori ekonomik ankues, pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, 59, 60 dhe 62 të LPP-së dhe neni 43. par 5 të Rregullores nr.001/2022.

-Administrimi dhe vlerësimi i provave-

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 07.12.2023 ka autorizuar eksperten shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 989/23, ndërsa me datë 15.12.2023 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me nr. 2023/0989 me rekomandimet si në vijim: "Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK mbi anulimin e aktiviteti të prokurimit".

Lidhur me pretendimet e "CTA" SH.P.K ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/0989, ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: Ekspertja shqyrtuese fillimisht sqaron se AK përmes formularit B58 Njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues Komuna e Pejës me dt:13.11.2023, ka rekomanduar për kontratë për 'LOT 1 Punimi i ngrohje, ventilimit dhe ujësjellësit" operatorin ekonomik ankues "CTA" Sh.p.k (ankues). Pas publikimet të këtij njoftimi, operatori ekonomik "Ejona" sh.p.k parashtron kërkesë për rishqyrtim me datë 20.11.2023, me pretendimin se OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar çmimin zero për artikullin/pozicioni A.6 –Banesat sociale e reja, dhe çmimi zero në paramase është i ndaluar sipas LPP-së dhe nuk lejohet vlera zero në paramase. AK-Komuna e Pejës aprovon si pjesërisht të bazuar kërkesën për rishqyrtim te operatori ekonomik "Ejona" sh.p.k dhe lenden e rikthen në rivlerësim. Pas rivlerësimit, AK me datën 24.11.2023 anulon aktivitetin e prokurimit, përkatësisht Lot 1, me arsyetimin se: "Ky aktivitet i prokurimit anulohet për shkak të gabimeve që kanë ndodhë gjatë përgatitjes se specifikave tenderit gabimet janë të pa riparueshme në ketë fazë, prandaj e vetmja mundësi është korrigjimi i specifikave teknike te tenderit nga njësia kërkues dhe ri shpalljen e tenderit me procedura të përshpejtuar siç e parasheh LPP-ja". Ekspertja shqyrtuese bazuar në shkresat e lëndës, pretendimet e ankuesit dhe arsyetimin e anulimit të aktivitetit të prokurimit, vlerëson se gabimet të cilat kanë ndodhë në paramasë dhe parallogari nuk munden në ketë fazë të evitohen / përmirësohen. Po ashtu, edhe OE ankues potencon në ankesë se "Kompania jonë me rastin e ofertimit ka vërejtur që në paramasa parallogarit pozicioni A.6 Shkuma për fiksim me montim te sasia nuk është vendosur fare sasia (sa copë) nevojiten , prandaj ne kemi vendosur vetëm çmimin për njësi ndërsa tek vlera totale nuk kemi vendosur çmimin për arsye që sasia nuk ka qenë vendosur nga AK dhe ne kemi pasur të pa mundur te vendosim vlerën totale tek ky pozicion, para gabimi qëndron tek AK që nuk kanë vendosur sasinë tek pozicioni A.6.". Meqenëse, OE ankues e potencon që e "ka vërejtur" se pozicioni A6 nuk është vendosur sasia, ka mundur që të bëjë kërkesë për sqarime të tenderit me qëllim të përmirësimit të paramasës lidhur me pozicionin A6 të paramasës dhe të mos vjen deri të anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit. Andaj, në këtë fazë nuk mund të përmirësohet ky gabim në paramasë, ndërsa vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është i pamundur të bëhet konform nenit 59 të LPP, dhe për këtë arsye ekspertja konsideron se duhet të vërtetohet vendimi i AK-së për anulim të kësaj procedure. Prandaj në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, sqarimeve dhe provave të bashkangjitura si më lartë, ekspertja shqyrtuese propozon që të vërtetohet vendimi i AK-së që ky aktivitet i prokurimit anulohet për shkak të

gabimeve tek paramasa dhe parallogaria e autoritetit kontraktues, ankesa e operatorit ekonomik ankues të refuzohet si e pabazuar. Ndërsa autoriteti kontraktues gjatë ri shpalljes të këtij aktivitetit të prokurimit të ketë parasysh nenin 17.12, i Rregullores Nr.001_2022 për prokurimin publik, përcakton: "...Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata sqaruese shtesë.."

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar me rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, paneli shqyrtues sqaron se aktiviteti i prokurimit është anuluar për shkak të gabimeve që kanë ndodhë për fajin e AK gjatë përgatitjes se DT, konkretisht tek paramasa dhe parallogaria.

Paneli shqyrtues konform mendimit të dhënë nga ekspertja shqyrtuese vlerëson se gabimet të cilat kanë ndodhë në paramasë dhe parallogari nuk munden në ketë fazë të evitohen / përmirësohen. Paneli shqyrtues sqaron se AK që nuk kanë vendosur sasinë tek pozicioni A.6", gjë që e pohon edhe Ankuesi në ankesën e parashtruar në OSHP, andaj paneli shqyrtues vlerëson që meqë OE ankues e potencon që e "ka vërejtur" se pozicioni A6 nuk është vendosur sasia, ka mundur që të bëjë kërkesë për sqarime të tenderit me qëllim të përmirësimit të paramasës lidhur me pozicionin A6 të paramasës dhe të mos vjen deri të anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit. Andaj, në këtë fazë nuk mund të përmirësohet ky gabim në paramasë, ndërsa vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është i pamundur të bëhet konform nenit 59 të LPP, dhe për arsyet e cekura si më lartë konsideron se duhet të vërtetohet vendimi i AK-së për anulim të kësaj procedure.

Mbi bazën e sqarimeve të dhëna nga eksperti shqyrtues, paneli shqyrtues vlerëson se vendimi i AK-së pas rivlerësimit të këtij aktiviteti për anulim të procedurës së prokurimit duhet të vërtetohet për shkak të gabimeve tek paramasa dhe parallogaria e autoritetit kontraktues.

Andaj, paneli shqyrtues duke u bazuar në këtë informacion të detajuar dhe duke u bazuar edhe në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues u bind se ky aktivitet të prokurimit duhet të anulohet në tërësi dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK për anulim. Për shkak se paneli shqyrtues nuk mund të detyroj AK që të vazhdoj me një aktivitet të prokurimit i cili ka shkelje dhe mund të paraqet pabarazi në mes të palëve dhe mund të paraqet vështirësi gjatë realizimit të kontratës. Andaj Paneli e konsideroj të arsyeshme që me rastin e vendosjes meritore në këtë çështje juridike-administrative, tua njeh të drejtën e kthimit të tarifës ankimore. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast nuk përbejnë bazë të

mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore dhe pohimeve të AK, të cilat Paneli sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i këtij aktiviteti në Rivlerësim duke pasur parasysh natyrën e këtij aktiviteti po ashtu thirrjen nga njësia kërkuese (nga aspekti profesional), paneli sipas gjykimit të pavarur konsideron se nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Po ashtu duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për panelin shqyrtues dhe çdo raport i tillë vlerësohet dhe analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, pohimeve te palëve, akteve dhe veprimeve të tyre, natyrisht duke e pasur parasysh edhe natyrën e shkeljeve eventuale në raport me qëllimin dhe rrjedhën e një aktiviteti të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli Shqyrtues nëse e mbështet ndonjë raport apo ndonjë rekomandim të ekspertizës, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional te panelit ashtu siç i adresohen kompetencat e tilla sipas nenit 105 te LPP. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se aktiviteti i prokurimit duhet të anulohet në tërësi

Në përfundim të gjithë kësaj, Paneli vendosi sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, nisur nga bindja dhe gjykimi i pavarur i tij se ka aplikuar zgjidhjen e duhur në ketë rast, ndërkaq obligon autoritetin kontraktues që gjatë ri shpalljes të këtij aktivitetit të prokurimit duhet të ketë parasysh nenin 17.12, i Rregullores Nr.001/2022 për prokurimin publik, ku thuhet: "...Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre".

- Përfundim -

Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i aprovuar në ketë çështje është i bazuar në administrimin e të gjitha provave, në dispozicion të kësaj lënde dhe se në marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 dhe 6 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KOMUNA E PEJES**
- OE - **" CTA " Sh.p.k.**
- Arkivës së OSHP-së: